

RREGULLORE

DETYRAT DHE TE DREJTAT E PUNONJESVE TE HEKURUDHES NE LEVIZJEN E TRENAVE

Detyrat dhe te drejtat e K/Dispecerit

(Teknikut te levizjes)

1. Drejton dhe udhezon dispecerit e levizjes se trenave
2. Analizon realizimin e grafikut te levizjes se trenave dhe punen e dispecerise lidhur me levizjen, nxjerr te metat, mer masa dhe organizon punen per nje drejtim te mire ne turnet pasardhese.
3. Studion dhe percekton masat e nevojeshme per shfrytezimin me te mire te fuqise terheqese, rritjen e brutove, uljen e shpenzimeve etj.
4. Ndjek ne menyre operative shprendarjen e mjeteve te transportit dhe levizjen e tyre brenda kohes se duhur.
5. Perpilon aktet teknike te stacioneve, me qellim qe te eliminohen vendet e ngushta ne drejtim te levizjes si dhe te rritet ne shkalle me te larte sigurimi teknik i levizjes se trenave.
6. Ne bashkepunim me dispecerin e turnit zgjidh ne menyre operative situatat e nderlikuara ne levizjen e trenave.
7. Organizon punen dhe pergjigjet per ngritjen tekniko-profesionale te disapecerave ne levizjen e trenave.
8. Studion dhe ben projekt grafiqe te levizjes se trenave me qellim qe te arrihet nje grafik sa me racional per realizimin e detyrave te transportit te udhetareve dhe mallrave.
9. Mer pjese ne komisionin e provave te D.H. per leshimin e deshmive te aftesise profesionale te punonjesve te levizjes.
10. Mer pjese ne komisionin qendror te avarive.
11. Nderhyn menjehere per eliminimin e rasteve te shturjes ne grafikun e levizjes se trenave.

12. Ka te drejte te jape urdhera per te terhequr nga detyra cdo punonjes te levizjes se trenave qe ben shkelje flagrante te RSHT-se dhe rrezikon sigurimin teknik te levizjes se trenave: duke raportuar ceshtjen menjehere ne inspektoriatin hekurudhor per marjen e masave.
13. Propozon masa disiplinore per dispecerat e levizjes dhe punonjesit e qarkullimit, te cilet thyejne disiplinen e punes ne levizjen e trenave.
14. Therret per raport para kryetarit te deges dhe udheheqes te ndermarjes punonjes me pergjegjesi te stacioneve hekurudhore lidhur me kryerjen e detyrave te ngarkuara.
15. Ne bashkepunim me kryetarin e deges mendon per pergatitjen e elementit te ri ne dispecerine qendrore te levizjes se trenave.
16. Nderpret cdo veprim qe mund te sjelle rrezikshmeri ne levizjen ne levizjen e trenave.
17. Varet nga kryetari i deges dhe e zevendeson ate.
18. Pergjigjet per te gjithsa detyrat qe rrjedhin per te nga RSHT-ja instruksioni i sinjalizimit, dhe gjithë rregulloret e udhezimet e leshuara nga D.H.
19. Njeh dhe zbaton gjithë masat e nevojeshme te mbrojtjes ne pune per personin e vet dhe shoket e punes. Njeh dhe zbaton rregullat per sigurimin kunder zjarrit.
20. Kontrollon punen teknike te cdo stacioni, postet e levizjes dhe formimin e trenave jo me rralle se nje here ne tre muaj. Ne perfundim te cdo kontrolli le detyra me shkrim per permiresimine gjendjes.
21. Raporton me shkrim ne keshillin teknik mbas cdo kontrolli tre mujor, mbi kontrollin teknik te stacioneve dhe posteve te levizjes dhe propozon masan qe nuk jane ne kopetencat e tij.

Detyrat e te drejtat e dispecerit te levizjes se trenave

1. Pergjigjet per zbatimin e grafikut te levizjes se trenave brenda turnit te tij.
2. Drejton ne menyre operative levizjen e trenave, duke u bazuar ne grafikun baze ne grafikun e levizjes te miratuar nga Ministria e Komunikacionit.
3. Ploteson grafikun ditor me te gjithë te dhenat operative te marra nga inspektorat e sherbimit.

4. Rregullon levizjen e trenave dhe ben the gjitha perpjekjet per te futur ne grafik trenat e vonuar.
5. Ka te drejte te jape urdhera per te gjitha problemet qe kane te bejne me levizjen e trenave.
6. Ndjek ne menyre operative levizjen e trenave, jep urdhera per marje e lenie vagonash ne stacione
7. Njofton dhe kontrollon oren ekzakte cdo 12 ore.
8. Pergjigjet per shfrytezimin racional te fuqise terheqese te lokomotivave.
9. Ndjek ne menyre operative respektimin e grafikut te levizjes se trenave.
10. Eleminon te metat qe sjellin crregullime ne zbatimin e grafikut te levizjes trenave.
11. Kerkon zbatimin e grafikut te levizjes se trenave brenda te gjithe rregullave te RSHT.
12. Zbaton mire shprendarjen e mjeteve te transportit.
13. Nderpret cdo veprim qe bie ne kundersizim me RSHT
14. Terheq nga detyra cdo punonjes ne sherbim te qarkullimit brenda turnit te tij, puna e metejshme e te cilit sjell rrezikshmeri ne levizjen e trenave.
15. Propozon per masa ndershkimore kunder punonjesve te levizjes qe thyejne rregullat dhe sjellin pasoja crregullimi ne levizjen e trenave.
16. Anullon ose shton trena malli brenda dhe jashte grafikut te levizjes sipas situatave qe krijohen ne levizjen e trenave.
17. Pergjigjet per zbatimin e te gjitha detyrave qe rrjedhin per te nga RSHT-ja instruksioni i sinjalizimit dhe te gjithe rregulloret e udhezimet e leshuara nga Drejtoria e Hekurudhave.
18. Njeh dhe zbaton te gjitha masat e nevojeshme te brojtjes ne pune per personin e tij dhe shoket e punes. Njeh dhe zbaton rregullat per sigurimin e formimin e trenave dhe te masave kunder zjarrit.
19. Gjate turnit te tij kontrollon zbatimin e urdherave qe kane te bejne me levizjen e trenave dhe gadishmerine nga ana e personelit, te levizjes ne stacione.
20. I ndalohet perdorimi i pijeve alkolike para marjes se sherbimit dhe gjate sherbimit.

21. I ndalohet gjate sherbimit qe te shkeputet nga drejtimi I levizjes se trenave ose te fleje ne gjume.
22. Mer dhe dorezon sherbimin me proces verbal.

Detyrat e te drejtat e dispecerit te qarkullimit te stacionit

1. Kontrollon punen per zbatimin e rregullave ne levizjen e trenave dhe te manovres ne stacionet vartese.
2. Organizon punen e personelit te qarkullimit.
3. Kontrollon punen per formimin e rregullt te trenave.
4. Kontrollon ditën dhe natën gadishmerine e personelit ne cdo post te levizjes se trenave.
5. Pergjigjet per zbatimin e aktit teknik te stacionit.
6. Organizon punen per pastrimin, kompletimin e garniturave te udhetareve dhe per nje sherbim te kulturuar dhe pa rreziqe ne trena salla etj. Mer masa per funksionimin e qendrave te zerit dhe per propogandimin e rregullave te sigurimit teknik dhe pastertise ne te gjithë teritorin.
7. Eshte i detyruar te kryeje kontrole ditën dhe natën ne drejtimet dhe afatet e me poshtme.
 - Nje here ne 10 dite ne bashkepunim me brigadierin e mirembajtjes se linjes, kontrollon nderrueset ne stacionet dhe postet e levizjes qe varen prej tij. Kujdes te vecante te tregohet per kontrollin e tyre gjate kalimit te mjeteve mbi nderruese.
 - Kontrollon plotesimin e detyrave qe kane te bejone me sigurimin teknik te levizjes ne cdo post levizje jo me rralle se dy here ne muaj natën.
 - Nje here ne 10 dite se bashku me elektromekanikun e sinjaleve dhe mekanikun e sinjalve te zones dhe brigadierin e linjes te kontrolloje ne cdo post levizje giendjen e aparaturave, paisjeve dhe mekanizmave te sugurimit, centralizim-bllokimit dhe sinjalizimit.
 - Nje here ne muaj ne afatet qe korespondojne me kontrollet individuale se bashku me teknikun e linjes, brigadierin qe ka ne vartesi linjat e sektorit dhe elektromekaniku i sinjaleve ne menyre te organizuar kontrollon postet e levizjes, nderrueset linjat e stacionit, paisjet e sinjalizimit te nderlidhjes per zbatimin e rregullave e te detyrave.
8. Kontrollon mbajtjen ne rregull te dokumentacioneve te levizjes se trenave ne te gjitha postet e levizjes.

9. Pergjigjet per paisjet e personelit me uniforme, sinjale, deshmi aftesie dhe te gjitha paisjet e tjera te nevojeshme.
10. Mer pjese ne komisionin e avarive dhe ate te provave per leshimin e deshmeve te aftesise personelit te levizjes qe jane ne nomenklaturen e stacionit.
11. Drejton kurset e kualifikimit te punonjesve te qarkullimit.
12. Pergjigjet per masat e sigurimit teknik, mbrojtjen ne pune, mbrojtjes kunder zjarrit ne postet e levizjes dhe per permiresimin e kushteve te punes.
13. Mer pjese ne kontrollet periodike qe organizon D.H. ne sektorin e tij.
14. Ndalon cdo veprim qe sjell rrezikshmeri ne levizjen e trenave.
15. Heq nga detyra cilido, puna e te cilit sjell rrezikshmeri ne levizjen e trenave ne sektorin vartes dhe propozon marjen e masave.
16. Ben propozime per ngritjen ne pergjegjesi te vartesve te tij.
17. Bashkepunon me punojesin e kuadrit per marjen e elementit te ri dhe ripertesitjen e personelit te qarkullimit.
18. I propozon shefit te stacionit per ndryshimet e rastit ne aktin-teknik te stacionit qe ky dokument te jete sa me aktual dhe jua ben te njohur personelit te stacionit.
19. Pergjigjet per zbatimin e te gjitha detyrave qe rrjedhin per te nga RSHT-ja instruksioni i sinjalizimit dhe gjitha rregulloret e udhezimet e leshuara nga D.H.
20. Njih dhe zbaton gjitha masat e nevojeshme te mbrojtjes ne pune per vehten e tij dhe shoket e punes. Njih dhe zbaton rregullat per sigurimin kunder zjarrit.

Detyrat dhe te drejtat e inspektorit te jashtem

1. Drejton levizjen e manovres ne territorin e stacionit
2. Pret dhe nis personalisht trenat e mallit dhe te udhetareve
3. Sigurohet ne formimin e trenave te mallit dhe te udhetareve dhe pergatitjen e rregullt te tyre per nisje.

4. Mbikqyr te gjithë levizjen manovruese
5. Para se te mare sherbimin kontrollon te gjithë punen e stacionit lidhur me gjendjen e linjave nderruese formimin dhe shprendarjen e trenave dhe paraqitjen e personelit vartes ne sherbimin conform rregullave.
6. Kontrollon dhe pergjigjet per veprimet e vartesve te tij gjate kohes se kryerjes se manovres dhe ne kohe qe nuk ka levizje ne stacion.
7. Drejton ne menyre operative te gjithë punen me trenat dhe manovren ne stacion Mban pergjegjesi per kryerjen e sakte dhe te rregullt te saj si dhe per zbatimin e aktit teknik te stacionit.
8. Merr ne dorezim trenat e mallit qe vijne ne stacion si dhe dokumentacionet perkatese te vagonave.
9. Mban lidhje te ngushte me operativin e stacionit per dorezimin dhe marjen ne dorezim te vagonave me dokumentat perkatese.
10. Zbaton urdherat e inspektorit te brendeshem per sa i perket levizjes se trenave ne stacion
11. Pret dhe kontrollon cdo tren qe hyn ose kalon ne stacion dhe bindet per rregullaritetin e tij
12. Pergjigjet per rregullin e trenave qe nis nga stacioni
13. Ndalon nisjen e vagonave qe nuk jane ngarkuar sipas rregullave teknike
14. Prej tij varet i gjithë personeli trenave dhe te lokomotivave qe vijne ose jane ne stacion
15. Heq nga detyra personelin qe ka ne vartesi kor konstaton shkelje te rregullave teknike puna e metejshme e te cilit sjell rrezikshmeri.
16. Ndalon punen ne linjat, nderrueset dhe paisjet e tjera kur konstaton te meta dhe difekte te palejueshme.
17. Urdheron lokomotivat e transportit per te kryer manover ne stacionin e tij.
18. I ndalohet kategorikisht te perdore pije alkolike para dhe gjate kohes se kryerjes se sherbimit.
19. Paraqitet ne pune i paisur me mjetet e novejeshme sinjalizuese te dites dhe nates.

20. I ndalohet kategorikisht te heqe vemendjen nga kryerja e detyrave dhe te flere gjume kur eshte ne sherbim qofte dhe atehere kur nuk ka levizje trenash dhe manover ne stacion. Gjithashtu keot veprime nuk ja lejon dhe varteseve te tij
21. Mer ne dorezim sherbimin me proces verbal
22. Pergjigjet per zbatimin e te gjitha detyrave qe rrjedhin per te nga RSHT instrukioni i sinjalizimit dhe gjitha rregulloret dhe udhezimet e leshuara nga D.H.
23. Njeh dhe zbaton te gjitha masat e novejshme te mbrojtjes ne pune per personelin e tij dhe shoket e punes. Njeh dhe zbaton rregullat per sigurimin kundra zjarrit.
24. Njeh dhe zbaton aktin teknik te stacionit.
25. Kontrollon brigadat e pastrimit te vagonave te udhetareve dhe pergjigjet per pastrimin e tyre brenda kohes normale te nisjes se trenit nga stacioni.

Detyrat dhe te drejtat e inspektorit te sherbimit te brendeshem

1. Drejton te gjitha levizjen e trenave dhe ne stacionet qe kane pasijet per kthimin automatik te nderruesve, edhe te manovres ne teritorin e stacionit.
2. Kryen mareveshjet me stacionet fqinje per pranimin dhe nisjen e trenave.
3. Mer dhe dorezon sherbimin me process verbal
4. Ne nje liber te vecante dorezon tavolinen e komandimit dhe kontrollin optik, duke shenuar edhe arsyet e perdorimit te butonave Sr, Bd, dhe Bn.
5. Mban te plumbosura butonin Lnd dhe grupin e singurencave te grupit.
6. Ne rast kur per arsye teknike lind nevoja e perdimit te butonit Lnd per kthimin e nderruesve, e shenon kete ne librin e proces verbaleve dhe njofton menjehere elektromekanikun e sinjalizimit dhe brigadierin qe ka ne varesi linjat e stacionit, per eliminimin e defektit. Mbas eliminimit te defektit kerkon perseri plumbosjen e butonit Lnd nga elektromekaniku i sinjalizimit duke shenuar dhe oren ekzakate te cplumbosjes se tij.
7. Ne asnje rast per cfaredo arsye qofte nuk i cplumbos vete sigurencat e nderruesve. Kjo pune do te kryhet vtem nga elektromekaniku i sinjalizimit.

8. Perpara se te pranoje trena ne linjat e stacionit me izolim te prishur, mer nga inspektori i jashtem konfirmimin mbi qenien e tyre te lire nga mjetet hekurudhore ose trenat dhe pastaj perdor butonat ose pasijet per pranimin e trenave ne keto linja te stacionit.
9. Perpara se te perdore butonin Lnd per kthimin e nderrueseve me izolim te prishur duhet te sigurohet per qenien e tyre te lire nga mjetet hekurudhore.
10. Per asnje arsye dhe per cdo arsye qofte, nuk i lejohet te perdore butonin Lnd pa formuar kete bindje.
11. Perpara se te filloje pune per levizjet manovruese ne stacion, kerkon nga inspektori i sherbimit i jashtem planin e manovres.
12. Lejon levizjet manovruese mbasi te bindet qe nderrueset jane vendosur ne pozicionin e kerkuar.
13. Ne rast kur megjithse ka lejuar levizjen manovruese, lokomotivat tek ose me vagona nuk levizin, nuk e cvendos pozicionin e nderruesve per pergatitjen e rugeve te kalimit per trenat e tjere ose levizje te tjera manovruese, pa u siguruar prej inspektorit te jashtem se ajo levizje u anulua. Po keshtu vepron edhe ne rastet qe vete per arsye te tjera u anulon kete levizje.
14. Nuk lejon levizjen e mjeteve nemanover, kur qofte edhe njera prej nderruesve qe marin pjese ne rrugen e kalimit nuk tregon pozicionin ne tavolinen e kamondimit.
15. Per kete arsye nga inspektori i jashtem te verifikojte gjendjen ne vend dhe mbasi mbasi mer shpjegime prej tij vepron. Njekohesisht merr masas per lajmerimin e elektromekanikut te sinjalizimit per eleminimin e difektit.
16. Pregatit dhe siguron rrugen e kalimit per te gjitha trenat qe hyjne ose dalin nga stacioni me sinjal rezerve ne semafor.
17. Asnje rast nuk i lejohet te vendose ne semafor sinjalin rezerve si per dalje ashtu edhe per hyrjen e trenave kur ka kryer vetem vendosjen e thjeshte te nderruesve ne pozicionin e kerkuar dhe nuk ka bere sigurimin e rruges se kalimit.
18. Vrojton te gjitha trenat qe hyjne, dalin ose kalojne ne stacion per gjendjen dhe sinjalizimin e tyre. Kur konstaton te meta qe rrezikojne sigurimin e levizjes merr masa per ndalimin e levizjes se tyre te metejshme.
19. Per levizjen e trenave dhe rradhen e kalimit te tyre varet nga dispeceri i levizjes, urdherat e te cilit i zbaton para gjitha te tjereve.

20. Manovren e kryen sipas kerkesave te inspektorit te jashtem.
21. Per te kryer nje levizje te rregullt te trenave te manovres vazhdimisht konsultohet, bashkepunon dhe koordinon veprimet me inspektorin e jashtem.
22. Per asnje moment nuk I lejohet te heqe vemendjen nga detyra dhe kontrolli I levizjes se mjeteve ose trenave ne tavolinen e komandimit dhe kontrollit optik. I ndalohet ne menyre kategorike qe te flere ne kohen e sherbimit edhe ate here kur ne stacion nuk ka levizje trenash.
23. I ndalohet ne menyre kategorike perdorimi i pijeve alkolike para marjes sse sherbimit dhe ne kohen e kryejes se tij.
24. Shenon ne librin e telefonogrameve oren e sakte te hyrjes, daljes dhe kalimit te trenave ne stacion .
25. Ne rast kur aparatura nuk funksionon per mareveshjen me stacionet fqinje per levizjen e trenave, kryhen me te mareveshje telefonike me shkrim ne librin e telefonogrameve per pranimin dhe nisjen e trenave.
26. Pergjigjet per zbatimin e te gjitha detyrave qe rrjedhin per te nga RSHT instruksioni i sinjalizimit dhe te gjitha rregulloret e udhezimet e leshuara nga D.H
27. Nje dhe zbaton gjithe masat e nevojeshme per mbrojtjen ne pune per personin e tij dhe shoket e punes. Njeh dhe zbaton rregullat per sigurimin kundra zjarrit dhe aktin teknik te stacionit.

Detyrat dhe te drejtat e K/Trenit mallit

1. Pergjigjet per sigurimine trenit qe ka marre ne dorezim dhe jep urdher per te gjitha problemet e lidhura me trenin kur ai ndodhet ne linje te hapur.
2. Kontrollon garnituren e trenit para marjes ne dorezim dhe vendos per nisjen e trenit mbasi te jete bindur qe garnitura eshte formuar ne rregull, nuk ka te mete teknike ose komerciale, jane plotesuar dokumentat e elvizjes dhe treni eshte i paisur me sinjalet dhe personelin e nevojeshem.
3. Gjate udhetimit te trenit duhet te shohe sinjalet, te kujdeset per levizjen e sigurte te trenit dhe te frenoje ne rastet e nevojeshme. Te komunikojte me mashinistin me anen e sinjaleve ne kthesa etj.
4. Bindet dhe pergjigjet per ngarkesat dhe sigurimin e mallrave ne vagonat e hapur
5. Mer pjese ne manover dhe drejton ate ne stacionet ndermjetese.

6. Kur eshte ne stacion varet nga inspektori i sherbimit, nderse kur treni ndodhet ne linje te hapur eshte pergjegjesi kryesor i tij dhe ka ne vartesi pervec frenuesve dhe brigaden e lokomotives.
7. Pergjigjet materialisht per cdo demtim te mjeteve ose mallrave gjate udhetimit dhe ne manover.
8. Nuk pranon lidhjen ne tren te vagonave qe kane te meta teknike.
9. Mer masa per mbrojtjen e trenit dhe per te gjitha veprimet qe duhen bere ne rastet kur treni ka ndaluar ne linje te hapur.
10. Mer pjese ne proven e frenave te trenit ne stacionet kur nuk ka ose mungon kontrolli i vagonave.
11. Merr dhe dorezon ne rregull dokumentat e trenit se bashku me planin e formimit te tij tek inspektori i sherbimit. Po kete veprim e ben edhe ne stacionet ndermjetese ku len ose mer vagona.
12. Paraqitet ne sherbim me mjetet e nevojeshme sinjalistike te dites dhe nates. Kete gje e kerkon edhe nga vartesit e tij.
13. Pergjigjet per zbatimin e gjitha detyrave qe rrejdhin per te nga RSHT-ja instruksioni I sinjalizimit dhe gjitha rregulloret e leshuara nga D. Hekurudhore.
14. Njeh dhe zbaton te gjitha masat e nevojeshme te mbrojtjes ne pune per personelin e tij dhe shoket e punes. Njeh dhe zbaton rregullat per sigurimin nga zjarri te trenit.
15. I ndalohet kategorikisht te flere ne kohen e sherbimit edhe atehre kur ne stacion nuk ka kevizje.

Detyrat dhe te drejtate K/Trenit te udhetareve

1. Eshte pergjegjes kryesor I trenit ne stacion e ne linje, ka ne vartesi pervec brigades te shoqeruesve dhe brigaden e lokomotives.
2. Pergjigjet per sherbimin e kulturuar dhe pa rreziqe te udhetareve dhe pasijen e trenit me sinjale komplet.
3. Mer pjese ne nisjen e trenit dhe jep sinjalin e nisjes mbasi te bindet qe linja eshte e lire dhe jane plotesuar ne rregull te gjitha dokumentacionet e nevojeshme dhe eshte bindur per hyrjen e udhetareve dhe mbylljen e dyerve te vagonave.

4. Nuk lejon nisjen e trenit par orarit dhe kujdeset per respektimin e plote te tij.
5. Pergjigjet per pastrimin e rregullin e trenit.
6. Kontrollon dhe ndihmon vazhdimisht shoqerueset e vagonave lidhur me sigurimin e udhetareve nga rreziqet dhe qendron gjithnje ne gadishmeri per cdo veprim qe i takon sigurimit te levizjes.
7. Organizon me ane te qendrave te zerit informacione per udhetaret per mberritjen dhe nisjen e trenave te udhetareve.
8. Gjate kryejres dhe daljes ne stacione kontrollon sinjalet ne semaforet e hyrjes dhe daljes dhe mer masa per zbatimin e tyre kur personeli i zbaton dhe ne stacionet ku mungojne semaforet te verifikojte dhe te perserise sinjalin e inspektorit te sherbimit.
9. Zgjidh ne bashkepunim me brigadierin e lokomotives cdo situatë lidhur me levizjen e trenit ne linje dhe mer masa per sigurimin e trenit ne rast ndalimi te paparashikuar ne linje.
10. Gjate kohes se qendrimit ne stacion varet nga inspektori i sherbimit.
11. Ndalon trenin per rastet kur konstaton ndonje veprim te pa rregullt lidhur me sigurimin e levizjes se tij.
12. Pergjigjet per te gjithë zbatimin e te gjithë rregullave qe rrjedhin per te nga RSHT-ja instruksioni i sinjalizimit dhe te gjithë rregulloret e udhezimet e leshuara nga D.H.
13. Njeh dhe zbaton gjithë masat e nevojeshme te mbrojtjes ne pune per personin e tij dhe shoket e punes. Njeh dhe zbaton rregullat e sigurimit kunder zjarrit ne tren.
14. Para marjes ne dorezim te garnitures kontrollon se bashku me brigaden e pastrimit vagonat.
15. Gjate udhetimit vazhdimisht kontrollon levizjen e trenit sinjalet e mashinistrin dhe te personelit tjetër.
16. Paraqitet ne pune me sinjale komplet te dites dhe nates dhe kontrollon personelin vartes per paisjen komplet me to.
17. I ndalohet te perdori pije alkoolike para marjes dhe gjate sherbimit.
18. I ndalohet te shkeputet nga drejtimi dhe kontrolli i levizjes se trenit ne kohen e sherbimit.

Detyrat dhe te drejtat e K/Manovristit

1. Pergjigjet per perdorimin e trenit te mallit brenda orarit te caktuar ne grafikun e levizjes se trenave dhe konforme RSHT.
2. Mbasi kontrollon vagonat per gjendjen e ngarkeses se tyre, plumbosjen ganxhimin dhe per vagonat me ganxhim automatik qenien e spinotit ne : folene e vet dhe i siguruar me kopile, mer numrat e vagonave dhe i sponton ato me Gj.M.T. pastaj mbi kete baze harton planin e manovres.
3. Ndalon levizjen manovruese te vagonave qe kane qofte edhe nje nga te metat e me sipërme te parashikuar ne piken 2
4. Para fillimit te punes udhezoi brigaden e manovres (manovristat dhe nderruesat) duke jua bere te qarte punen e manovres dhe cakton detyrat. Ben shprendarjen e manovristave ne vendet e punes.
5. Organizon dhe drejton punen manovruese brenda rregullave te shfrytezimit dhe te sigurimit teknik dhe mbrojtjen e personelit gjate manovres.
6. Pergjigjet per manovrimin ne kohe me saktesi dhe pa avari si per formimin e trenave ashtu dhe per vendosjen e vagonave ne stacion dhe linjat industriale.
7. Organizon punen e manovres me nje shfrytezim sa me ekonomik te lokomotives gjate manovres.
8. Ben formimin e cformimin e trenave ne stacion.
9. Njeh mire aktin teknik te stacionit dhe punon mbi kete baze per punen e manovres ne stacionin e tij.
10. Varet direkt nga inspektori i sherbimit dhe mban lidhje te ngushta me operativin e turnit per punen e vendosjes se vagonave per perpunim.
11. Kontrollon dhe siguron paisjen me ninjale te vartesve te tij.
12. Heq nga detyra manovristat qe nuk punojne konforme rregullave te manovres dhe sjellin rrezikshmeri ne levizjen e trenave.
13. Propozon masa ndershkimore per ata qe thyejne disiplinen ne pune dhe nuk zbatojne rregullat e shfrytezimit teknik e te sigurimit teknik te levizjes.
14. Paraqitet ne detyre i fresket fizikisht.

15. Paraqitet ne sherbim me mjetet sinjalistike te nevojeshme te nates dhe dites, kete kerkon dhe nga vartesis e tij.
16. I ndalohet kategorikisht perdorimi i pijeve alkolike para dhe ne kohen e kryerjes se sherbimit.
17. I ndalohet kategorikisht te terheqe vemendjen nga kryejra e detyres dhe levizja e trenave si dhe te flere ne kohen e sherbimit edhe atehere kur ne stacion nuk ka levizje.
18. Pergjigjet per zbatimin e te gjitha rregullave qe rrjedhin per te nga RSHT instruksioni sinjalizimit dhe te gjithe rregulloret e udhezimet e leshuara nga D.H.
19. Njeh dhe zbaton gjithe masat e nevojeshme te mbrojtjes ne pune per personin e tij dhe shoqeve te punes. Njeh dhe zbaton rregullat per sigurimin kundra zjarrit dhe aktin teknik te stacionit.

Te drejtat dhe detyrat e manovristit.

1. Kryen punen e manovres pa reziqe dhe ne baze te planit te manovres.
2. Ben lidhjen dhe zgjidhjen e vagonave duke respektuar rregullat e sigurimit ne pune.
3. Pergjigjet per zbatimin e shpejte dhe me perpikmeri te urdhrerave dhe te detyrave qe i jepen ne kohen e manovrimet.
4. Kontrollon linjen ku do te kryhet manovra.
5. Mban pergjegjesi per cdo demtim te mjeteve gjate manovres dhe te siguroje mbrojtjen personale dhe te personave te tjere qe mund te rrezikohen gjate manovres.
6. Mban ne gadishmeri sinjalet personale dhe i perdor ato sipas nevojës.
7. Gjate sherbimit varet nga K/manovristi ose inspektori i sherbimit
8. Ndalon cdo levizje te mjeteve, ne rastet kur veren ndonje pasiguri qe mund te sjelle pasoja.
9. Kur vendos ne garnituren e trenit vagona qe kane te meta ne kundrshtim me rregullat teknike
10. I ndalohet perdorimi i pijeve alkolike para marjes se sherbimit dhe gjate sherbimit
11. I ndalohet kategorikisht te flere ne kohen e sherbimit edhe atehere kur ne stacion nuk ka levizje.

12. Paraqitet ne sherbim i paisur me mjetet e nevojeshme sinjalistike te dites dhe nates.
13. Pergjigjet per zbatimin e gjithë detyrave qe rrjedhin per te nga RSHT-ja instruksioni i sinjalizimit dhe gjithë rregulloret e udhezimet e leshuara nga D.H.
14. Njeh dhe zbaton gjithë masat e nevojeshme te mbrojtjes ne pune per personin e tij dhe shoket e punes. Njeh dhe zbaton rregullat per sigurimin kundra zjarrit.

Detyrat dhe te drejtat e nderruesit

1. Pergjigjet per mbajtjen e nderruesve ne gjendje te rregullt per pastrimin e tyre, vajisjen, shterngimin e bullonave etj.
2. Pergjigjet ne kohe te erret te fenerevete sinjaleve te nderruesve simbas aktit teknik te stacionit.
3. Pergjigjet per mbajtjen ne pozicion normal te nderruesve dhe cvendos ato vetem me urdher te inspektorit te sherbimit, kurse gjate manovres me kerkesen e drejtuesit te manovres.
4. Pergjigjet per pergatitjen e rregullt dhe sigurimin e rruges te kalimit trenit per rajonin qe ka ne varersi.
5. Gjate marjes se sherbimit eshte i detyruar te bindet ne prezencen e punonjesit qe ja derezon atij sherbimin ne se ne vagonat qe gjenden ne rajonin e tij nuk kane shkelur shtyllen e kontrollit dhe nese jane te siguruar nga rreshqitja, ne se nderrueset dhe pasijet e tjera te sigurimit qe perdoren nga ai funksionojne ne menyre te rregullt, ne se nderrueset jane te pastra, ne se vartesia dhe mjetet e sinjalizimit jane komplet dhe ne gjendjen e duhur.
6. E mer dhe e dorezon shëbimin me prcos verbal
7. Gjate manovres eshte i detyruar te veshtroje me kujdes sinjalet dhe ti zbatoje me perpikmeri, duke siguruar ne kete menyre punen e rregullt dhe pa rrezik te manovres.
8. Ndhmon ne punen e manovres kryen dhe pergjigjet per levizjen e rregullt te nderruesve.
9. Per cdo demtim te nderruesve njofton menjehere inspektorin e sherbimit, mer masa per sigurmin e levizjes dhe ne rast ne nevojë ndalon qarkullimin ne keto nderruese.
10. Paraqitet ne sherbim me mjetet sinjalistike te nevojeshme te dites dhe nates dhe I mabn ne rregull ato.

11. Nuk lejon njez te pa autorizuar te prdorin nderrueset, te qendrojne ne kabinen e tij ose te qendrojne e kalojne ne territorin e tij.
12. Per asnje moment edhe ateher kur nuk kerkohen veprime nga ana e tij, nuk i lejohet te dobesoje gadishmerine, te flere ne kohen e sherbimit dhe te heqe vemendjen nga detyra.
13. Te vije i fresket fizikisht dhe shpirtarisht ne pune.
14. Per asnje moment nuk duhet te lere postin e sherbimit.
15. Gjate sherbimit varet nga inspektori i sherbimit dhe pergjigjet para tij.
16. Pergjigjet per zbatimin e gjithë detyrave qe rrjedhin per te nga RSHT –ja instruksioni I sinjalizimit dhe gjithë rregullave e udhezimeve te leshuara nga D.H
17. Njeh dhe zbaton te gjithë masat e nevojeshme te mbrojtjes ne pune per personin e tij dhe shoket e punes. Njeh dhe zbaton rregullin per sigurimin kunder zjarrit.
18. I ndalohet kategorikisht perdorimi i pijeve alkolike para marjes se sherbimit dhe ne kohen e kryerjes se sherbimit.

Detyrat dhe te drejtat e frenuesit

1. Pergjigjet per kontrollin, funksionimin dhe perdorimin e frenit te dores te vagonit te tij. Frenon trenin sa here qe kjo kerkohet dhe ne rastet kur konstaton rrezikshmeri jep edhe sinjalet perkatese.
2. Pergjigjet per mbajtjen ne gadishmeri dhe funksionimin e rregullt te sinjaleve te fundit te trenit gjate udhetimit ashtu edhe gjate qendrimit te trenit ne stacion.
3. Ben shterngimin e zinxhirave te ganxhave te ganxhave te vagonave para nisjes se trenit
4. Mer pjese ne punen e manovres simbas urdherave qe i jepen nga kryetari trenit.
5. Kontrollon gjate gjithë kohes udhetimit trenin dhe pergjigjet per lirimin e shtylles se kontrollit gjate hyrjes se tenit ne stacion.
6. Mban ne gjendje te rregullt sinjalet personale dhe ato te trenit
7. Mer masa per mbrojtjen e trenit te ndaluar ne linjet te hapur

8. Gjate sherbimit varert nga kryetari I trneit dhe pergjigjet para tij.
9. Ndjek levizjen e tenit ne linje te hapur, shikon dhe trasmeton sinjalet
10. Per asnje moment nuk e heq vemendjen nga detyra e tij.
11. Ne sherbim paraqitet i fresket fizikisht dhe shpirterisht.
12. Paraqitet ne sherbim me te gjitha mjetet sinjalike te nevojeshme te dites dhe nates.
13. I ndalohet kategorikisht te shkeputet nga kryerja e detyrave te tij dhe te flere ne gjume gjate sherbimit.
14. I ndalohet kategorikisht qe te perdori pije alkolike para marjes se sherbimit dhe kryerjes se tij.
15. Pergjigjet per zbatimin e te gjitha detyrave qe rrejdhin per te nga RSHT-ja instruksioni I sinjalizimit dhe gjitha rregulloret dhe udhezimet e leshuara nga D.H
16. Njeh dhe zbaton gjitha masat e nevojeshme te mbrojtjes ne pune per personin e tij dhe shoket e punes. Njeh dhe zbaton rregullat per sigurimin kundra zjarrit ne tren.
17. Kur treni ndodhet ne stacion eshte pjestar i brigades se manovres.

Detyrat dhe te drejtat e shoqeruesve te vagonave

1. Pergjigjet per sherbimin e kulturuar dhe pa rreziqe te udhetareve.
2. Pergjigjet materialisht per gjitha inventarin e vagonit dhe per mbrojtjen e tij nga demet.
3. Pergjigjet per pastertine dhe rregullin ne vagon
4. Kontrollon hyrjen e udhetareve dhe ndihmon per sistemimin e tyre dhe te plackave ne vagon. Ndalon konfuzionet dhe hyrjen e elementeve keqberes dhe pa bileta ne vagon.
5. Pergjigjet per sigurimin e udhetareve nga rreziqet, mer masa per mbylljen e dyerve para nisjes se trenit dhe gjate levizjes se tij ndalon qendrimin neper shkalle jashte vagonit, perkuljet nga dritaret dhe levizjen e kote te udhetareve.
6. Kontrollon vazhdimisht biletat e udhetimit sipas zonave perkatese dhe pergjigjet materialisht per udhetaret qe nuk jene nisur me bilete.

7. Pergjigjet per ndricimin dhe ventilimin e vagonit.
8. Qendron ne gadishmeri per cdo nevojje te udhetareve dhe per cdo veprim qe kerkon sigurimi teknik i levizjes.
9. Per asnje moment nuk I lejohej te heqi vemendjen nga detyrat e saj.
10. Kujdeset ne menyre te vecante per te moshuarit invalidet, grate dhe sidomos femijet.
11. Vendos rregull ne hyrje daljen e udhetareve duke qendruar vete prane hyrjes per te evituar cdo konfuzion.
12. Zgjidh vete me inisjative cdo situatë dhe ne rast nevojje kerkon ndihmen e kryetares se trenit ose personelit tjetër kunder shkeljeve e demtimeve, terheq opinionin e mases se udhetareve.
13. Pergjigjet per parqitjen korrekte mirembajtjen e uniformes personale dhe paisjen me mjetet e nevojeshme sinjalike te nates dhe dites.
14. Ndjek me kujdes sinjalet dhe I jep vete ne rast nevojje
15. Ndalohet braktisja e vagonit qendrimi ne kabinen e saj gjate udhetimit dhe kur ne vagon ka udhetare, shkeputja nga detyra gjate qendrimit te trenit ne stacion.
16. Ndalon trenin ne raast rrezikshmerie me anen e dorezes frenimit te menjehereshem.
17. Pergjigjet per zbatimin e te gjitha detyrave qe rrjedhin per te nga RSHT, instruksioni i sinjalizimit dhe gjithë rregulloret e udhezimet e leshuara nga D.H.
18. Njeh dhe zbaton gjithë masat e nevojeshme per mbrojtjen personale ne pune per personin e tij dhe shoket e punes. Njeh dhe zbaton rregullat e sigurimit kundra zjarrit ne tren.
19. I ndalohet kategorikisht te perdori pije alkolike para marjes se sherbimit.

Detyrat dhe te drejtat e rojes se kaleses hekurudhave

1. Pergjigjet per ruajtjen e kalesave hekurudhore si dhe per mbylljen ne kohe te blloqeve.
2. Mban librin e telefonogrameve duke u lidhur me inspektorin e sherbimit nga i cili varet.
3. Mer dhe dorezon sherbimin me process verbal

4. Kontrollon cdo dite gjendjen e kaleses duke e mbajtur ate ne gjendje te rregullt dhe te paster.
5. Pergjigjet per mbajtjen ne gjendje te paster te hapesires ndermjet shines dhe kondrashines.
6. Pergjigjet per mbajtjen ne gadishmeri te materialeve stabel, te sinjaleve te fundit sinjalet e dores personale telefonit dhe orarit te levizjes se trenave.
7. Kontrollon cdo tren qe kalon dhe per cdo te mete si mungese e sinalit te fundit te trenit, difekt vagonash, ngarkesa jo te rregullta mer masa per ndalimine trenit ose nofton menjehere instruktorin e sherbimit.
8. Preet cdo tren duke dhene sinjalet perkatese.
9. Duhet te jete I gatshem per mbrojtjen e linjes se demtuar dhe ne rast avarie.
10. Pergjigjet per mbajtjen ne gadishmeri te blloqeve dhe per cdo demtim lajmeron per rregullimin e tyre.
11. Nuk lejon futjen e personave te pa autorizuar ne bllok.
12. Varet nga inspektori i sherbimit dhe pergjigjet para tij.
13. Pergjigjet per te gjitha detyrat qe rrjedhin per te nga RSHT, instruksioni I sinjalizimit dhe te gjitha rregullave dhe udhezimeve te leshuara nga D.H.
14. Njeh dhe zbaton gjitha masat e nevojeshme te mbrojtjes ne pune per personin e tij dhe shoket e punes. Njeh dhe zbaton rregullat per sigurimin dhe mbrojtjen kunder zjarrit.

Detyrat dhe te drejtat e instruktorit mashinist

1. Pergjigjet per gjendjen teknike te lokomotivave ne qarkullim dhe ne punen e personelit te lokomotivave me mirembajtjen e mjeteve dhe zbatimin e rregullave
2. Mer pjese ne zgjedhjen dhe pergatitjen e personelit te lokomotivave.
3. Ben instruktimin praktik dhe teorik te personelit te lokomotivave ne baze te rregulloreve dhe dijeve teknike ne kurse dhe ne procesin e punes.

4. Jep rekomandime paraprake per ngritjen e personelit te lokomotivave dhe mer pjese ne komisionin e provave.
5. Ndjek nga afer gjendjen shendetesore dhe punen e personelit te lokomotivave duke qene sa me afer tyre si ne pune dhe ne jete duke qene ne rolin e edukatorit per to.
6. Ne pjesen me te madhe te kohes dite dhe 4 here naten ushtron kontrole ne locomotive
7. Kontrollon cdo 2 jave me lokomotive ose drezine gjendjen e linjave dhe te nderruesve.
8. Njih dhe ndjek nga afer gjendjen teknike te lokomotivave dhe nderhyn ne kohe per eliminimin e difekteve.
9. Mer dhe jep ne dorezim lokomotivat ne sherbim dhe riparim nga oficina. Mbikqyr kryerjen e punimeve simbas nomenklatures dhe cilesise.
10. Ndjek zbatimin e grafikut mujor te sherbimit te lokomotivave.
11. Ndjek nga afer punen e personelit per kryerjen e sherbimeve ditore dhe trajtimin e mjeteve.
12. Ndjek konsumin e karburanteve ne lokomotive dhe propozon masa ne drejtim te kursimit te tij.
13. Ndjek dhe ndihmon personelin ne zbatimin e shpejtesise se levizjes, shfrytezimin e pendencave, procesin e frenimit etj.
14. Mer pjese ne komisionin e avarive dhe gjykon punen e personelit qe ka ne varesi
15. Drejton provat me ngarkese dhe pa ngarkese ne linje lokomotivave.
16. Nderhyn per eliminimin e dobesive dhe te metave qe konstatohen me mashinistat gjate sherbimit te tyre ne te gjithe sektoret e hekurudhes.
17. Kontrollon punen ne formimin e trenave punen e kontroloreve te vagonave, gjendjen e frenave, te vagonave, te linjes, proceset e manovres etj eshte ne rolin e inspektorit ne ndihme te inspektorit hekurudhor.
18. Bashkepunon me dispecerin e levizjes per nje shfrytezim rracional te fuqise terheqese, per rritjen e rendimentit dhe uljen e shpenzimeve.
19. Ndjek gjendjen e vend furnizimeve me uje, karburant, lubrifikant rere etj, dhe te kanaleve te pastrimit e sherbimit ne te gjitha stacionet dhe park.

20. Terheq nga qarkullimi cdo lokomotive qe nuk eshte ne gjendje te mire teknike. Per rastet qe e sheh te arsyeshme therret komisionin teknik.
21. Terheq menjehere nga detyra dhe bene zevendesimin e personelit te lokomotives, puna e metejshme e te cilit sjell rrezikshmeri ne levizjen e trenave per arsye shendetesore, pune te pandergjegjeshme, mungese aftesie mos zbatim rregullash dhe kur konstaton se nuk e ka bere rregjimin ne rregull dhe nuk eshte pergatitur per sherbim. Ceshtjen e raporton menjehere tek pergjegjesi i parkut per mbledhjen e komisionit te shkeljeve te rregullave per marje masa perkatese.
22. I ndalohet perdorimi i pijeve alkolike gjate sherbimit.
23. Pergjigjet per zbatimin e te gjitha detyrave qe rrjedhin per te nga RSHT'-ja instruksion i sinjalizimit dhe te gjitha rregulloret dhe udhezimet leshuara nga D.H
24. Njih dhe zbaton te gjitha masat e nevojeshme te mbrojtjes ne pune per personin e tij dhe shoket e tij. Njih dhe zbaton rregullat per sigurimin kundra zjarrit ne lokomotive.

Detyrat dhe te drejtat e mashinisteve

1. Te jete fizikisht i shendoshe, vecanrisht te shohe dhe degjoje mire.
2. Ben jete te rregullt. I ndalohet kategorikisht te perdore pije alkolike parap marjes dhe gjate sherbimit.
3. Te beje rregjim pushimi detyrimisht para marjes se sherbimit. Te paraqitet ne sherbim ne gjendje normale shendetesore dhe shpirterore. Ne rast pamundesie te paraqitjes te lajmeroje dispecerin e parkut te pakten 6 ore para marjes sse sherbimit.
4. Te jape ne dispecerine e parkut adresen e sakte te banimit dhe ne rast te ndryshimit te saj, te njoftoje menjehere. Per cdo largim jashte rrethit te lere adresen e sakte ne shtepi.
5. Pergjigjet per gjendjen e mire teknike te lokomotives dhe te veglave qe ka ne inventar.
6. Kryen ne rregull dhe me perpikmeri sherbimin M1 te lokomotives duke i beret e gjitha sherbimet e nevojeshme.
7. Ushtron kontroll te vazhdueshem ne te gjithe nyjet e mjetit dhe njofton menjehere instruktorin machinist ose dispecerin e parkut per cdo defect sa do te vogel qe nuk eshte ne gjendje ta eliminoje vete.

8. Paraqitet ne komisionin e provave per riprovimin cdo vit sipas dates se shenuar ne deshmi 15 dite para skadimit te afatit.
9. Deri ne moshen 40 vjec kryen kontroll mjeksor nje here ne 5 vjet, deri ne 50 vjec nje her ne 3 vjet, dhe mbi 50 vjec nje here ne vit.
10. Nuk lejon te hypin ose te perdorin lokomotiven njereze te pa autorizuar.
11. Eshte direkt personi pergjegjes per udheheqjen e lokomotives dhe per rimorkimin e rregullt te trenit.
12. Nuk i lejohet te behet zevendesimi i njeri tjetrit para mbarimit te kohes normale te sherbimit pa aprovimin e dispecerise se pasurkut.
13. Ne ditet qe nuk eshte urdheruar te punoje ne lokomotive eshte i detyruar te paraqitet ne dispeceri ne orarin e caktuar.
14. Rimorkion rregullisht trenat sipas intenerarit te caktuar. Nuk I lejohet te kaperceje per cdo arsye qofte shpejtesine maksimale te lejuar ne udhezizmet e leshuara nga drejtoria.
15. E mer dhe dorezon sherbimin me proces verbal
16. Gjate gjithë kohes se udhetimit ndjek me kujdes levizjen e trenit dhe brigaden e trenit, sinjalet qe I jepen dhe I zbaton me rigorozitet ato.
17. Ne asnje moment dhe per cdo arsye qofte nuk i lejon vetes dhe ndihmesit qe te shkeputet nga detyra.
18. I ndalohet kategorikisht qe te flere gjume qofte edhe atehere kur lokomotiva eshte ne gjendje qetesie. Kete veprim nuk ja lejon as ndihmesit te tij dhe mban pergjegjesi.
19. Nuk I lejohet te leje vetem lokomotiven nen drejtimin e ndihmesit ne kohen qe ajo eshte ne levizje ose ne manover ne stacion.
20. I ndalohet te levize lokomotiven vetem pa prezencen e ndihmesit ne postin e tij.
21. Gjate udhetimit kontrollon trenin, sidomos ne kthesat per gjendjen e rregullt te tij dhe te ngarkesave.
22. Para nisjes per udhetim kontrollon trenin sidomos ata te mallit per gjendjen e tyre teknike dhe funksionimin e sistemit te frenimit.

